

## Gjermani/ FSV Frankfurt fal Edmon Kapllanin

nga AlbaniaSoccer

E martë, 10 Dhjetor 2013 18:07

---



Edmon Kapllani ka rifituar faljen. FSV Frankfurt e ka rikthyer shqiptarin ne skuader duke i dhene fund pezullimit te tij. Sulmuesi u denua disa jave me pare nga drejtuesit e klubit gjerman per shkak te nje zenke ne stervitje. Sjellja e mire e Kapllanit dhe nevoja qe skuadra ka per ta i ka detyruar drejtuesit ta rikthejne pa pritur fundin e denimit qe vinte ne muajin janar. Kapllani me 7 golat e tij eshte vene ne qender te vemendjes dhe disa skuadra ne Gjermani e duan. FSV Frankfurt duke dashur te mos e humbase me parametra zero e ka rikthyer sulmuesin ne skuader.